




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 12, shkronja d, neni 17, dhe neni 40 shkronja c të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenin 36.2, shkronja d të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, Kuvendi i Komunës së Vitisë, në mbledhjen e mbajtur më datën 27.11.2023 merr këtë:

VENDIM

për rritjen e mjeteve nga të hyrat vetanake të vitit 2023

Neni 1

Me këtë, Kuvendi i Komunës së Vitisë miraton vendimin për rritjen e buxhetit komunal nga të hyrat vetanake të vitit 2023 dhe shpërndarjen në vitin 2023.

Pasi që Komuna ka arrit të bëjë tejkalimin e planit të të hyrave vetanake (të planifikuara në vlerë prej 1,052,819 €), e deri tani të realizuara 1,293,470.49 €, diferenca e rritjes është 240,651.49 €. Andaj kërkojmë që të aprovohet rritja e buxhetit komunal në vlerë prej **60,000.00 €** të vitit 2023.

Neni 2

Rritja e buxhetit komunal nga të hyrat vetanake komunale propozohen të shpërndahen në këto kategori ekonomike:

1. Mallëra e shërbime në shumë prej 60,000.00 €.

Të shpërndara në këto nënprograme buxhetore:

Në kategorinë ekonomike mallëra dhe shërbime shuma prej 60,000.00 € në nënprogramet:

- Zyra e Kryetarit (16033), shuma prej 15,000.00 €;
- Shërbimet e shëndetësisë primare (74950), shuma prej 45,000.00 €.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: kryetari i Komunës së Vitisë, Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim.

Neni 4

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrim të Pushtetit Lokal, në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), neni 8 lidhur me neni 9 të Rregullores Nr.10/2019 për Procedurat e Hartimi dhe Publikimi të Akteve të Komunave, dhe pas publikimit në web faqen e Komunës së Vitisë

Vendimi u dorëzohet:

1. Zyrës së Kryetarit;
2. MAPL-së; dhe
3. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË

KRYESUESI

Bekim Azizi

Arsyetim: Komuna ka tejkaluar planin e të hyrave vetanake të vitit 2023 në vlerë prej 240,651.49 €, e kërkohej në vlerë prej 60,000.00 € të rriten mallrat e shërbimet. Rritja e të hyrave në vlerë 60,000.00 €, në mallra dhe shërbime bëhet për arsye të pagesës së obligimeve ndaj operatorëve ekonomik në Sektorin për Shëndetësi nga të hyrat vetanake në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve të programi i Zyrës së Kryetarit dhe të programi i